



Rapsodi shqiptare

FREDERIK RESHPJA



891986-1

R.55

FREDERIK RESHPJA

5

R

RAPSODI SHQIPTARE

(Vjersha dhe poema)

SHIPTËRIA E BOTONJËSE
FRASHËRI

~~45356~~

34656

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

KUR GJËMONTE HISTORIA

Më duket se mijra vjet kam jetue mbi
këtë tokë
Tue lexue hieroglifet e kuqe të vetëtimave
Dhe vargjet e vrejtun të maleve shqiptare.

Ç'stuhi të mëdha shkruenin vallë vetëtimat
Mbi kurrizin e reve
Dhe epokave?
Përmes stuhish dhe furtunash,
Njëmijë herë jam ngritë nën kryqzimin
e shpatave,
Nën kryqzimin e shkrepave dhe rrufeve;

Njëmijë herë jam ngritë
Mbi konstruktin madhështor të maleve
të mia;

O ju male, male të larta
Rrufepritësa gjigandë,
Kur gjëmonte historia!...

PARTIZANI

Ja, mbi këtë bregore e ngjitën partizanin;
E vunë me shpatulla nga Ylli i Mëngjezit
Dhe shënuen në gjoksin e tij
Ku zgjoheshin andrrat,
Ku zgjoheshin dashunitë;
Dhe krismat trembën gjumin nga fshati
Dhe fluturuen tutje mbi selvitë.

Po lindëte...
Retë morën udhën e horizontit;
Po tue mbartë në sup Yllin e Mëngjezit
Ai ngjitej qetë-qetë në kujtesën e kombit.

JEMI NE...

Kush jemi né?

Jemi buzëqeshja e lirshme që u
mungonte kohnave;

Jemi filizat e pranverës së ardhme.

Mbimë

Pas krismave partizane, mes gjëmimesh

Udhëve të jetës,

Udhëve të Atdheut.

Malet e larta dhe ne na thërrasin,

Ujvarat plot ylbere,

Agimet malore,

Gjurmëve të etënve né, tani, shklasim

Mbi kujtime, andrra e mbi net hanore.

U ngritëm si degë të gjelbërta

Pas kohnave të stuhishme, plot thëllim;

Ne jemi pranvera që u mungonte shekujve,

Erdhëm të hedhim sipër malesh gjelbërim.

ALPET

Lugina të kaltërta, ku mbijnë agimet,
Përrenj që zbresin si kope të bardha;
Shkrepa pleq, të menduem,
të vrazhdë

Dhe, nëmbi këta,
Buzëqeshja e kaltër e qiellit.

MËNGJEZI

Sot,
unë e hapa mëngjezin;
Unë
ish partizani i vjetër që kthehesha nga zbori.

Perdet e errta të reve lëkundeshin në lindje
Dhe dielli i madh - ja ndjeva hapat,
Afrohej t'u vinte flakën reve.

Po kthehesha nga zbori me pushkën në dorë
Anës grunajes që e mbolla po unë
Dhe kisha ndërmend gjithë fshatin e fjetun,
Unë,
ish partizani i vjetër që kthehesha nga zbori.

Sot unë e hapa mëngjezin;
Perdet e reve i ngrita, po unë
Dhe Diellin e Madh e solla, po unë.

PËRSHËNDETJE

U ngritën Alpet mbi luginat e kaltërta
Tue vërtitë mes mjegullash
Qeleshet e tyne të bardha...

Gjëmoi avioni lart
Mbi dunat transparente, mbi ranishtet e mëdha
mjegullore.

Mbi lashtësinë e reve po kaloja,
Bloqe avujsh të shkallmuem nga stuhia.
O vend i dashun!
Me krahë të ngritun ylberësh,
Të përqafoj malet e mija!...

UDHA...

Këtë udhë
Ne e kemi ndërtue

Që të kaloni ju
Tue mbartë andrrat e ngarkueme randë:
Që të kaloni ju, brezi i ri,
Me gjithë bagazhin gjigand të së nesërme,
Me gjithë eksplozivin shpërthyes të ndjenjave
tueja,
Me gjithë çekanët, gëzimet dhe projektet kolosale,
Me gjithë dëshirat - sado të mëdha qofshin;
Që të kalojë puna dhe gëzimi
Dhe pesha e rëndë e fjalës sonë.

Pra që të kaloni Ju!...
Mbi trotuarët e fortë të udhës sonë,
Koha gjurmë do të lajë;
E tue vështruar që nga larg dritaren e hapun
kanatash

Njerëzit mund të fundin kokën...
Por prap

do të thonë:
— Këtë ata e ndërtuen.